



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:074754

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05487908

C.nr.168/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtares Elvira Emimi, si gjyqtare individuale, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A, me seli në Bulevardin Bill Klinton nr.5 Prishtinë, kundër të paditurit Xh. (N.) L. me adresë në fsh. K. (D. e M.) K.Lipjan, me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seance, me datë 09.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike SH.A, me seli në Bulevardin Bill Klinton nr.5 Prishtinë, kundër të paditurit Xh. (N.) L. me adresë në fsh. K. (D. e M.) K.Lipjan, me objekt kontesti kompensim dëmi, në këtë çështje juridike kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes përfaqësuesit, pranë kësaj gjykate me dt.21.03.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurit, me objekt kontesti kompensim i dëmit.

Gjykata me vërejtjen për taksë të dt.26.01.2024, e ka ftuar paditësen që brenda afatit prej 3 ditësh nga dita e pranimit të vërejtjes për taksë, kësaj gjykate t'ia paguaj taksën gjyqësore në vlerë për 20 euro, në të kundërtën nëse pagesa e taksës nuk bëhet brenda afatit ligjor të caktuar nga gjykata, konform nenit 253.5 të LPK-së padia e paditëses do të konsiderohet e tërhequr.

Me dispozitat e nenit 253 par. 4 të LPK-së përcaktohet "Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkangjet edhe vërtetimin mbi taksën gjyqësore, ndërsa sipas paragrafit 5 të po këtij neni, nëse paditësi edhe pas vërejtjes së dërguar nga ana e gjykatës nuk e paguan taksën gjyqësore, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirimin e tij nga pagesa e taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është e tërhequr".

Nga fletëkthesa për dorëzim personal, e cila gjendet shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi se paditësja, vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar me dt. 05.02.2024, dhe në afatin ligjor të caktuar nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi, (të cilin fakt gjykata e ka vërtetuar edhe nga konfirmimi i arkës së gjykatës) andaj gjykata konform nenit 253.5 të LPK-së, lidhur me nenin 102 të LPK-së, e lidhur me nenin 6.6 të udhëzimit administrativ nr.2008/2, për unifikimin e taksave gjyqësore, padinë e paditëses e konsideroi si të tërhequr.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 253.5 e lidhur me nenin 387.1. nën (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, mori aktvendim me të cilin u konsiderua padia e paditëses si e tërhequr.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMEORE NË PRISHTINË -DEGA NE LIPJAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.168/23 me dt. 09.02.2024.

G J Y Q T A R J A
Elvira Emini

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes në dorëzim të të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate.